



SHTYLLA II
ÇËSHTJE PRAKTIKE DHE ADMINISTRATIVE

Aspekte të veprës penale të kontrabandës

Nga Jola Frasheri

I. ABSTRAKTI

Ky shkrim ka si qëllim të analizojnë veprat penale në fushën e doganave dhe elementet e veçantë që secila figurë mbart. Krimet në fushën e doganave po zënë gjithnjë e më shumë hapësirë nëpër gjykatat kombëtare dhe evropiane. Karakteristikë e veçantë e tyre është se ato janë gjithnjë në zhvillim dhe legjislatori duhet të përpiqet të ruajë ritmin e kohës dinamike që po jetojmë. Këto krime janë me mjaft rëndësi që të studiohen dhe të analizohen, gjithashtu sepse në këtë mënyrë mund të parandalohen si dhe të merren masa rehabilituese për autorët e tyre. Veprat penale të kontrabandës dëmtojnë interesat e vendit duke prekur Buxhetin e Shtetit për rrjedhojë cenojnë sigurinë financiare në vend. Gjithashtu lloje të veçanta të kontrabandës cenojnë edhe pasuritë tona kombëtare artistike dhe arkeologjike. Është me shumë rëndësi përforsimi i misionit të tre pushteteve në luftën e vazhdueshme kundër kontrabandës, në kuadër të luftës kundër informalitetit.

Fjalë Kyçe: kontrabanda, dogana, kodi doganor, vepër penale, importi, eksporti.

Shkurtime:

BE	Bashkimi Evropian
KD	Kodi i Doganor, viti 2014, ndryshuar me ligjin nr. 32/2015, datë 2.4.2015
KP	Kodi Penal, viti 1995, ndryshuar me vendim nr. 89/2017, datë 22.5.2017
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
RSH	Republika e Shqipërisë

II. HYRJE

Në vendin tonë veprat penale të kontrabandës kanë qenë të njohura që në kohët e lashta, por nuk kanë qenë të rregulluara dhe të përkufizuara si sot. Shqipëria duke qenë një rrugë lidhëse për disa Perandori të kohës, (p.sh Perandorisë Romake me atë të Bizantit) ishte për rrjedhojë edhe një territor nga i cili shpeshherë kalonin mallra në mënyrë të pa lejuar. Në dispozitat e hartuara nga Komanda Austro-Hungareze, pas shpalljes së pavarësisë dhe krijimit të shtetit të parë shqiptar, kontrabanda u përmend në mënyrë të specifikuar në aktet e nxjerra¹. Më fjalën kontrabandë kuptohej eksportimi apo importimi i mallrave në rrugë ose mënyra të ndaluara. Edhe në Kodin Penal të Mbretërisë Shqiptare, kontrabanda përmendet si vepër penale, por jo në mënyrë të zgjeruar.² Sërish kjo vepër penale përfshihet në kodifikimin e vitit 1952 dhe 1977, Kode Penale të Republikës Socialiste. Kontrabanda si term u përdor fillimisht në gjuhën angleze në fillim të viteve 1500. Ajo si fjalë ishte huazuar nga gjuhët latine. Në qoftë

¹ Jano J. "Historia e Doganave - Politikat Doganore të Shtetit Shqiptar" në vitet 1912-2002, Shtëpia Botuese "ADS"2002, fq. 20

² Selenica T. "Shqipëria në vitet 1927", Shtypshkronja Tirana, 1928, fq 97-98

se gjurmojnë në latinishten mesjetare hasim fjalën ‘*contrabannum*’ e cila është një kombinim i "contra" (kundër) dhe "bannum" (dekret).

Përveç kontrabandës klasike që është ajo doganore, e kalimit në mënyrë të parregullt të mallrave, po zhvillohen forma të reja kontrabande siç është ajo “ekonomike”. Kjo lloj kontrabande ka si qëllim fshehjen e kostove të importit apo eksportit të mallrave. Ekzistojnë gjithashtu edhe forma të tjera të kontrabandës siç është ajo politike, e luftës, arkeologjike apo edhe artistike.³ Në këtë lloj rastesh kontrabanda kryhet edhe në nivel shtetëror, ku shtetet të cilat kryejnë kontrabandën duan të fitojnë informacion, pushtet apo të dominojnë shtetet e tjera.

Në vendin tonë, ato biznese që kryejnë kontrabandë, përpiqen vazhdimisht që të gjejnë mekanizma të rinj që të kontrabandojnë mallra. Kryesisht futen kontrabandë mallrat që kanë akcizë, më qëllim shmangien e detyrimeve doganore sepse detyrimi për t’u paguar për këto mallra është relativisht i lartë. Kur këto mallra shiten në tregun e zi kanë fitim të lartë për bizneset. Më e preferuara është kontrabanda e cigareve, por është mjaft e zhvilluar edhe ajo e naftës për shkak të përfitimeve të mëdha që mbart.⁴

Po bëhet gjithnjë edhe më e vështirë që të luftohet kontrabanda në mbarë botën për shkak të sofistikimit të metodave që kontrabanduesit përdorin. Aktualisht më shumë se dy miliardë konsumatorë në botë konsumojnë produkte të cilat janë të kontrabanduara, duke u kthyer në burim të konsiderueshëm fitimi për organizatat ndërkombëtare kriminale apo për mafien lokale.⁵ Legjislacioni komunitar ka vendosur rregulla të ashpra për kontrabandën. Kushdo që është fajtor për kontrabandimin e mallrave në mënyrë të vetëdijshme, për mallra që janë të ndaluara me ligj ose që kanë kaluar doganën, si edhe për mallra që merren, shiten, transportohen ose ndihmon në kryerjen e njërit prej këtyre akteve, mund të akuzohet për këtë veprë penale dhe mund të ngarkohet me dëme civile.

III. ANALIZA E VEPRËS PENALE TË KONTRABANDËS

Me veprat penale në fushën e doganave kuptohen ato vepra (veprime apo mosveprime) të kundraligjshme që prekin interesat shtetërore, të kryera me dashje dhe me qëllim përfitimi material.⁶ Veprat penale në fushën e doganave parashikohen në 13 figura të veçanta në Kodin Penal.⁷ Ndarja e figurës së përgjithshme të krimit të kontrabandës në figura të veçanta kontrabande është bërë nga ligjvënësi duke u nisur së pari, nga natyra e mallrave me të cilat bëhet kontrabanda, regjimi juridik i tyre, së dyti, nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të secilit prej këtyre llojeve të kontrabandës dhe së fundmi, nga subjekti.

³ Atty. Filamer Miguel D. “Smuggling”, <https://businessmirror.com.ph/smuggling-101/>, 2015

⁴ Prof.Dr..Shabani S., Dr. Hyseni A. “Ligji doganor dhe Praktika Gjyqësore”, Shtëpisë botuese “Dita 2000”, 2007, fq 15.

⁵ Delval.P. “Një alternativë aktuale kundër antifalsifikimit të politikave”, WAITO, 2011 DELVAL P “Një alternativë aktuale kundër antifalsifikimit të politikave”, WAITO, 2011.

⁶ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë

⁷ Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar; Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë; Neni 173 Kontrabanda me mallra të licencuar; Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera; Neni 175 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore; Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore; Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm; Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë; Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë; Neni 179/a Mos-deklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë; Neni 179/b Thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë së autoriteteve doganore; Neni 179/c Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet; Neni 179/ç Kontrabanda e kapitenit, pilotit ose ekuipazhit.

Kodi ynë Doganor ka përshkruar vetëm elementet e anës objektive të kontrabandës, ndërsa Kodi Penal është më i zgjeruar duke përfshirë të gjitha figurat e veprës penale të kontrabandës më të gjithë elementët duke filluar me objektin, subjektin, elementet objektive dhe elementet subjektive, siç do të analizohen më poshtë.

3.1 Objekti i Kontrabandës

Objekti i përgjithshëm i gjithë figurave të veçanta të krimit të kontrabandës është marrëdhënia juridike e vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj nga çfarëdo lloj veprimtarie që ka për qëllim shmangien nga pagimi në buxhetin e shtetit të detyrimeve doganore, të cilat në analizë të fundit, llogariten në të holla.⁸

Referuar të drejtës penale, çdo veprë penale (këtu përfshihen edhe krimet në fushën doganore), cenon apo vë në rrezik një objekt të caktuar të mbrojtur nga ligji. Në rastin e veprave penale të kontrabandës, po edhe për veprat e tjera penale, përveç objektit të përgjithshëm të përmendur më lart, doktrina njih edhe objektin grupor. Këtu përfshihen vepra penale në fushën e doganave, që për objekt kanë një grup marrëdhëniesh shoqërore, vlerash e interesash të rëndësishme, të ngjashme apo të përafërta.⁹

Në secilën nga figurat e veprave penale të kontrabandës objekti është i ndryshueshëm. Në veprën penale të kontrabandës me mallrat të ndaluara¹⁰ objekti është i drejtpërdrejtë dhe është marrëdhënia juridike që vendoset për të siguruar ndalimin e importimit dhe eksportimit të mallrave të ndaluar apo të kufizuara. Mallrat të ndaluar sipas Kodit të Doganave janë armët, lëndët radioaktive, mallrat me përdorim të dyfishtë¹¹, mbetjet, lëndët ozonholluese, llojet e rrezikuara të faunës dhe të florës së egër, lëndët narkotike dhe psikotrope.

Ndërsa në veprat penale të kontrabandës me mallrat që kanë akcizë,¹² me mallrat e licensuar¹³ apo me mallrat me regjim të ndërmjetëm¹⁴ objekti është marrëdhënia juridike që vendoset për importimin, eksportimin ose tranzitimin e mallrave për të cilat paguhet akcizë, mallrave të licensuara apo mallrave me regjim të ndërmjetëm. Dallimi thelbësor mes këtyre veprave penale qëndron në faktin se kontrabanda me mallrat e ndaluara ka për objekt mallra të paligjshme që nuk lejohen të hyjnë në tregun e RSH-së. Ndërsa kontrabanda me mallrat e tjera, ka të bëjë me mallrat e lejuara të cilat mund të qarkullojnë lirisht në treg

⁸ Ismet Elezi. "E Drejta Penale", Pjesa e posaçme, 2016.

⁹ Elezi I. Kaçupi S. Haxhia M. "Komentar i kodit penal të Republikës së Shqipërisë "Shtëpia Botuese "Kumi", 2013, fq.

¹⁰ Neni 171, KP 'Importimi, eksportimi apo tranzitimi i paligjshëm i mallrave të ndaluar që hyjnë e dalin në Republikën e Shqipërisë, i kryer me çdo mënyrë a mjet qoftë, dënohen me burgim gjer në dhjetë vjet'.

¹¹ "Mallra me përdorim të dyfishtë" janë lloje produktesh të veçanta, pajisje, materiale, software dhe teknologji, që nuk janë të projektuara posaçërisht për qëllime ushtarake, si dhe për punë e shërbime të lidhura me to, të cilat, përveç përdorimit civil, mund të përdoren për qëllime ushtarake ose terroriste apo në projektimin, prodhimin, përdorimin e armëve të paracaktuara për qëllime ushtarake, armëve të shkatërrimit në masë, mënyrat e përhapjes së tyre ose e pajisjeve eksplozive, bërthamore, përfshi këtu disa lloje materiale bërthamore, agjentë kimikë, bakterologjikë, biologjikë dhe përgatitja toksike' sipas ligjit Nr. 9707, datë 5.4.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë".

¹² "Produkte që i nënshtrohen akcizës" janë: a) produktet energjetike; b) alkooli dhe pijet alkoolike; c) duhani e produktet e duhanit. Sipas ligjit Ligj Nr. 61/2012 Për Akcizat Në Republikën E Shqipërisë.

¹³ Mallrat e pajisur me licensë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

¹⁴ Regjim doganor ku malli mund të kalojë: tranzit; në magazinim doganor; përpunim aktiv; përpunim nën kontroll doganor; në lejm të përkohshëm; përpunimi pasiv ose eksport. Sipas nenit 16, KD.

por mënyra sesi futen dhe sesi qarkullojnë këto mallra në tregun e RSH-së është në kundërshtim më ligjin. Autorët e këtyre veprave penale synojnë të shmangin detyrimet doganore ose të mashtrojnë në lidhje me sasinë apo cilësinë e mallrave duke u përpjekur të zvogëlojnë këtë detyrim.

3.2 Subjekti i Kontrabandës

Tek shumica e veprave penale në fushën e doganave 'subjekti' është i përgjithshëm. Mund të jetë subjekt i krimit çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale¹⁵ dhe është i përgjegjshëm.

Megjithatë ekzistojnë vepra penale të kontrabandës me subjekt të posaçëm. Kështu në veprën penale të kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore¹⁶, subjekti është i posaçëm pasi duhet të jetë një punonjës i doganave, si p.sh: drejtori i përgjithshëm i doganave, inspektorët, drejtorët e drejtorive rajonale, kryetarët e zyrave doganore apo edhe agjentët doganorë. Veçoria e kësaj figure krimi qëndron tek subjekti i tyre, i cili jo vetëm duhet të këtë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i ndërgjegjshëm, por edhe të ketë cilësi të veçanta dhe t'i përdorë ato gjatë kryerjes së veprës penale. Gjithashtu edhe personat që janë favorizuar nga punonjësit e doganave për kalimin e mallrave kontrabandë do të përgjigjen sipas nenit të kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore. Po ashtu edhe në veprën tjetër të kontrabandës së kapitenit, pilotit ose ekuipazhit subjekti është i posaçëm¹⁷.

Personat juridikë shqiptarë dhe të huaj mund të jenë subjekt të përgjegjesisë penale për veprën e kontrabandës së kryer, në rastet kur është kryer vepra penale e kontrabandës nga organet përfaqësuese në emër ose në dobi të tyre, nga persona të autorizuar nga personi juridik, si dhe kur kjo vepër është kryer në emër apo dobi të tyre, për shkak të mungesës së kontrollit apo mbikëqyrjes nga personi që drejton. Sipas ligjit nr. 754, datë 14.6.2007, "Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridike" kryesisht shoqëritë tregtare dhe OJF-të, njihen si subjekte aktive dhe pasive të veprës penale. Personi juridik ka përgjegjësi për vepra penale të kryera: në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij; në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik ose në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik.

Tashmë, përgjegjësia dhe ndëshkimi i personave juridikë përbën një fakt të padiskutueshëm, që shkon përtej skemave juridike tradicionale dhe rrënjët e tij i gjen në zgjidhje të caktuara të politikave penale.¹⁸ Dënimet kryesore që jepen për personin juridik janë gjoba ose mbarimi i personit juridik. Ndërsa dënimet plotësuese janë: mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik; vendosja e

¹⁵ *Ka përgjegjësi penale penale personi që në kohën e kryerjes së krimit ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç*". Neni 12, KP

¹⁶ "Kryerja e kontrabandës nga punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, qoftë edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet". Neni 175, KP

¹⁷ "Transportimi i mallrave pa manifest ose mungesa ose refuzimi i paraqitjes së manifestit dhe dokumenteve përkatëse, ngarkimi, shkarkimi ose transportimi i mallrave, udhëtarëve dhe bagazheve të tyre pa lejen e autoriteteve doganore, qëndrimi në vende ku nuk ka zyrë doganore ose ndalimi në afërsi të portit ose aeroportit pa lejen e autoriteteve doganore, shkarkimi ose transbordimi i mallrave në kundërshtim me legjislacionin doganor, mungesa në bordin e mjetit të mallrave që duhet të gjendeshin aty, në bazë të manifestit dhe dokumenteve të tjera doganore, e kryer kjo, sipas rastit, nga kapiteni, piloti ose ekuipazhi, dënohet me burgim deri në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet" Neni 179/ç, KP

¹⁸ Dr. Av. Bozheku N.; Prof. Dr. Elezi I. "Përgjegjësia penale e personave juridike", Shtëpia botuese Toena, 2012, fq 35-36..

personit juridik në administrim të kontrolluar; ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike; heqja e së drejtës së marrjes ose përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve; ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe burime financiare; heqja e së drejtës së ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive ose operacioneve dhe detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.

3.3 Elementi objektiv i Kontrabandës

Nga ana objektive krimi i kontrabandës kryhet me veprime aktive ose me mosveprime të kundërligjshme në disa forma e mënyra të ndryshme të cilat janë: me anë të importimit, eksportimit, kalimit tranzit, kalimit jashtë pikave doganore, me anë të fshehjes së plotë apo të pjesshme të mallit, me mosdeklarim të saktë në doganë apo me forma të tjera si për shembull: duke ushtruar korrupsion aktiv dhe pasiv kontrabanda në bashkëpunim me punonjësit e doganave të cilët janë korruptuar, duke mos kallëzuar ose duke ndihmuar.

Në kontrabandë, fshehja mund të përshijë fshehjen e një pjese të mallrave kontrabandë ose mund të shkojë dhe më tej, deri në fshehjen e transportit në tërësi¹⁹ duke shmangur kontrollet kufitare, duke realizuar transportin me anë të anijeve të vogla, aeroplanëve privatë, nëpërmjet rrugëve tokësore, apo tuneleve të kontrabandës.

3.4 Elementi subjektiv i Kontrabandës

Krimi i kontrabandës përgjithësisht kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, por ka raste kur kryhet edhe nga pakujdesia. Këto janë rastet e kontrabandës së kapitenit, pilotit apo ekuipazhit, kur ato nuk kanë dijeni për shkak të pakujdesisë, mungesës së kontrollit që në mjetin drejtuar prej tyre kanë mallrat të jashtëligjshme apo të futura në një mënyrë jo të rregullt. Vepra penale kryhet nga pakujdesia në dy lloje formash: (a) me vetëbesim të tepruar dhe (b) me anë të neglizhencës. Në rastin e parë personi e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojës, por nuk e dëshiron dhe me mendjelehtësi shpreson që ta shmangë atë.

Ndërsa kur kemi pakujdesi në formën e neglizhencës, jemi para rastit kur personi nuk e parashikon ardhjen e pasojave të dëmshme, megjithëse ishte i detyruar dhe kishte mundësi t'i parashikonte ato. Elementi dallues kryesor i kësaj forme pakujdesie është mungesa e parashikimit të pasojës. Në rastet që nuk vërtetohet se vepra penale është kryer me dashje, atëherë gjykata argumenton në vendimin e saj që është kryer nga pakujdesia dhe është në diskrecionin e saj që ta marrë parasysh këtë fakt në momentin që përcakton dënimin. Pakujdesia nuk mund të shmangë autorin nga përgjegjësia penale për veprën e kryer.

Motivi i kontrabandës janë dëshirat apo shtytjet psikologjike²⁰, për kryerjen e veprimit që provokojnë tek subjekti vendosmërinë për të kryer veprime. Këto veprime synojnë apo kryhen për kalimin, në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo sendeve të tjera, në/dhe nga kufiri shtetëror (doganor). Në lidhje të ngushtë me motivin është edhe qëllimi. Me qëllim kuptohet synimi që dëshiron personi të arrijë me anë të veprës penale²¹.

Për sa i përket veprës penale të kontrabandës qëllimi i saj konsiston në veprimtarinë mendore që përfshin në përfytyrimin e subjektit rezultatin e dëshiruar, mundësinë e posedimit të mallrave kontrabandë apo të

¹⁹Këto kalime të paligjshme janë të vlefshme edhe për kalimin e paligjshëm të emigrantëve.

²⁰Elezi I. Kaçupi S. Haxhia M. "Komentari i kodit penal të Republikës së Shqipërisë "Shtëpia Botuese "Kumi", 2013, fq. 132-133

²¹Ibid, fq. 134-135

përfitimeve që lidhen me to, të cilat mund të sigurohen vetëm nëpërmjet kalimit, në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo sendeve të tjera përmes kufirit doganor.²²

Faji përbën elementin e domosdoshëm të krimit të kontrabandës, prania e të cilit krijon kushte subjektive të përgjegjësive penale për kontrabandë. Faji, në një shkallë a në një tjetër, është vlerësuar gjithmonë nga e drejta penale, e hershme apo e vonë, si element i rëndësishëm, vendimtar për ekzistencën e veprës penale. Në parim penalizohet subjekti që vepron në mënyre të fajshme. Deri në verifikimin ligjor të fajit, i dyshuari për shkelje doganore prezumohet i pafajshëm, ndaj çdo ndërmarrje e veprime represive, si ndalimi i personit apo sekuestrimi, bllokimi i mallrave, i mjetit të transportit, etj, përmban riskun e dëmshpërlblimit, nëse subjekti i dyshuar rezulton i pafajshëm.²³

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kontrollet e viteve të fundit kanë vërtetuar përhapjen në shkallë të gjerë të informalitetit e të kontrabandës në fushën e doganave dhe luftimi e parandalimi i tyre ka dalë në plan të parë të organeve shtetërore. Dihet se shteti, nëpërmjet taksave e tatimeve doganore nxjerr të ardhura të konsiderueshme për buxhetin, prandaj çdo lloj kontrabande e mallrave pakëson të ardhurat e buxhetit të shtetit.

Kodi Penal në fuqi në krahasim me kodet e mëparshme ka bërë ndryshime të mëdha në lidhje me krimet në fushën e doganave, duke siguruar kështu një mbrojtje juridike penale më të efektshme nga veprat penale.

Në Kodin Doganor janë parashikuar dënime administrative për kontrabandën, ndërkohë janë parashikuar këto lloj dënimesh edhe për shoqëritë tregtare apo OJF-të në një ligj specifik, siç u përmend edhe më lart. Në këtë mënyrë, në Kodin Penal dhe në Kodin Doganor kemi një paketë normash, që parashikojnë përgjegjësinë penale për krimet e kryera në një prej degëve më të rëndësishme të ekonomisë së vendit, pra të veprimtarisë ekonomike të importimit, të eksportimit, të tranzitimit të mallrave, si dhe vendosjes nën një procedurë të veçantë doganore.

Autoritetet tona shtetërore duhet të punojnë për të përmbushur rekomandimet e raportit “Moneyval”²⁴, për të përmbushur standardet e Task Forcës, së Veprimit Financiar (FATF)²⁵ për luftën kundër pastrimit të parave, korrupsionit dhe konfiskimit të pasurive kriminale. Në strategjinë e fundit të Komisionit Evropian²⁶ për Ballkanin Perëndimor është theksuar se lufta e pastrimit të parave, është një nga elementët më të

²² Muça Sh. “E Drejta Penale, pjesa e përgjithshme”, Shtëpia botuese ‘Dudaj’ 2007, fq 53-54

²³ Elezi I. Kaçupi S. Haxhia M. “Komentari i kodit penal të Republikës së Shqipërisë “Shtëpia Botuese “Kumi”, 2013, 126-127

²⁴ MONEYVAL është një organ i përhershëm monitorues i Këshillit të Evropës i ngarkuar me detyrën e vlerësimit të pajtueshmërisë me standardet kryesore ndërkombëtare për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe efektivitetin e zbatimit të tyre, si dhe me detyrën e bërjes së rekomandimeve për në lidhje me përmirësimet e nevojshme në sistemet e tyre.

²⁵ Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) është një organ ndërqeveritar i themeluar në vitin 1989 nga Ministrat e juridiksioneve të saj anëtare. Objektivat e FATF janë vendosja e standardeve dhe promovimi i zbatimit efektiv të masave ligjore, rregullatore dhe operacionale për luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe kërcënimeve të tjera të lidhura me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

²⁶ https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf



rëndësishëm në fushën e sundimit të ligjit dhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të funksionarëve publikë, për këtë ai duhet të jetë prioritet strategjik për Shqipërinë.

Gjithashtu edhe ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, përcakton me hollësi mënyrën sesi do të ekzekutohen vendimet për sekuestrim dhe vendimet përfundimtare për konfiskim. Ky ligj i miratuar për të qenë një mekanizëm më efikas në ekzekutimin e plotë dhe në kohë të vendimit gjyqësor, për masën e konfiskimit të pasurive, ka pasur impakt pozitiv në funksionimin e sistemit të drejtësisë. Megjithatë duhet një bashkëpunim dhe koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve ligjzbatuese dhe ndërmjet të gjithë operatorëve të sistemit të drejtësisë.

Legjislacioni i ri doganor²⁷ i është përafuar shumë atij të Bashkimit Evropian²⁸, në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE. Ndërkohë nga ana tjetër ashpërsimi i dënimeve penale në Kodin Penal nuk pajtohet me Rekomandimet e Këshillit të Evropës²⁹ dhe me orientimet e shkencës së politikës penale për liberalizimin e Kodit dhe zëvendësimin e dënimit me burgim në më shumë raste me dënime alternative³⁰. Pavarësisht faktit se në legjislacionin tonë të brendshëm parashikohen dënimet alternative, fatkeqësisht në praktikë përdoren pak dhe është mbizotërues mentaliteti i ndëshkueshmërisë më së shumti sesa i ai riedukimit.

Duke u drejtuar nga dënimet alternative ndryshon fokusi i dënimit nga ndëshkim dhe izolim, në drejtësi restauruese dhe riintegruese për individin. E drejta penale bashkëkohore është duke u shkëputur gjithnjë e më shumë nga efekti ndëshkues apo shpagues i dënimit, duke u orientuar drejt drejtësisë restauruese. Tashmë edhe nën ndikimin e parimit të humanizmit që përshkon legjislacionin penal, pranohet gjerësisht se dënimi penal ndjek qëllimin e edukimit, risocializimit dhe riintegritetit të autorit të veprës penale paralelisht me rehabilitimin/zhdëmtimin e të dëmtuarit prej saj. Orientimi i gjykatave drejt kësaj lloji forme dënimi do jetë një zgjidhje efektive në kuadër të forcimit të të drejtave dhe lirive themelore.

²⁷Kodi i Doganave i Republikës së Shqipërisë.

²⁸Direktiva e BE 952/2013

²⁹Rekomandimet e Këshillit të Europës R(92) 16, R (97)12 dhe R (2000)22 të cilat fokusohen në fushën e alternativave të dënimit me burgim.

³⁰Kreu VII i KP, alternativat e dënimit me burgim:

1. Gjysmëliria (neni 58)
2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në prove (neni 59)
3. Qëndrimi në shtëpi (neni 59/a)
4. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik (neni 63)
5. Lirimi me kusht (neni 64)